



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 13/1 Prot.

Tiranë, më 19/4 /2011

Lënda: Rekomandim për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)**

KONSTATOVA

Më datë 09.03.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, **Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin, përpunimi i të dhënave sensitive të parashikuara në nenet 5,6,7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Transferimi ndërkombëtar i të dhënave parashikuar në nenet 8,9 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” .
- Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.
- Siguria e të dhënave personale, kategoria e mjeteve të përpunimit që përdoren, masat për sigurinë e të dhënave personale (neni27)
- Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21).

Komisioneri "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi, "ALUIZNI", gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij grumbullon dhe përpunon të dhëna personale të subjekteve, të cilët aplikojnë për legalizim objektesh dhe ndërtimeve informale si dhe të dhënat e stafit administrativ.

1-Kontrolluesi, ALUIZNI, Tiranë, në formularin e njoftimit për përpunimin e të dhënave, detyrim ligjor në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale" nuk ka deklaruar si më poshtë:

-**Në klasifikimin nr.3**, "Karakteristikat e sistemit për përpunimin e të dhënave personale", rubrika 3.1(përpunimi manual) është i pa deklaruar nga kontrolluesi.

-**Në klasifikimin nr.5**, "Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen", nuk ka deklaruar që përpunon të dhëna personale të kategorisë "nëpunës"

- **Në klasifikimin nr.6**, "Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen", nuk ka deklaruar që përpunon të dhëna personale të kategorisë "Formimi-diplomat-medaljet". Si dhe kategorinë, "Jeta profesionale"

- **Në klasifikimin nr.7**, "Të dhëna sensitive që përpunohen", kontrolluesi "ALUIZNI", nuk ka deklaruar tek rubrika "Gjendja penale".

-**Në klasifikimin nr.10**, "Masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale", nuk është deklaruar se *ky kontrollues nuk ka një dokument për mbrojtjen e të dhënave personale*.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", "*...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.*

2-Kontrolluesi ALUIZNI, Tiranë nuk ka një rregullore të brendshme të hartuar prej tij lidhur me mbrojtjen dhe konfidencialitetin për të dhënat personale .

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 27/2/c të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale";..., "*Udhëzon operatorët pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave*".

3- Kontrolluesi “ALUIZNI” Tiranë, publikon jo vetem listat emërore të përfituesve, siç dhe është parashikuar në VKM-në, nr.411, datë 19.05.2010, paragrafi 3, gërma ”a”, ku thuhet:”

Drejtoritë e ALUIZNI-it, pranë qarqeve, pas kualifikimit për legalizim të objekteve informale/shtesave pa leje në ndërtime me leje, veprojnë si më poshtë:

a)**Publikojnë në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit, listën e poseduesve të objekteve informale/shtesave pa leje në ndërtime me leje, që kualifikohen për legalizim,** por dhe të dhënat kryesore të objekteve si:

- 1.Numri i protokollit të vetdeklarimit.
- 2.Numri i pasurisë.
- 3.Sipërfaqja e parcelës në m2.
- 4.Sipërfaqja e parcelës, në kalim pronësie.
- 5.Sipërfaqja e bazës ndërtimore në m2.
- 6.Numri i kateve të objektit.

Në këtë mënyrë, bëhet jo vetëm identifikimi i përfituesve nga procesi i legalizimit, por dhe identifikimi i pasurisë së tyre të paluajtshme si e dhënë personale, edhe pse në VKM-në nr.411, datë 19.05.2010, është përcaktuar qartë se çfarë kategorie të dhënash do të publikohet, pra, vetëm **Lista e poseduesve**).

Vlerësojmë se, publikimi i të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme të përfituesve, paralelisht me emrat e subjekteve përfitues nga procesi i legalizimit, është i tepërt dhe i kalon kufijtë e qëllimit, për informim.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 5 pika1/c i ligjit. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”“ Të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit, dhe të mos e kalojnë këtë qëllim”.

Në nenin 5, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.. parashikohet shprehimisht se:” *Kontrolluesi është përgjegjës për zbatimin e këtyre kërkesave, në të gjitha përpunimet automatike ose me mjete të tjera të të dhënave*”,

Gjithashtu në nenin 3, pika 3 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.. parashikohet shprehimisht se:” *“Kontrollues është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët vetëm apo në bashkëpunim më të tjerë mbajnë përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhëna personale*”.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të Nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) duhet të riformuloj Formularin e njoftimit duke plotësuar të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i inspektimit.
2. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 te ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) duhet të hartojë rregullore të brendshme ose të përfshijë në rregullore aktuale seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit të sipërmendur.
3. Në zbatim të nenit 5 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) duhet të aplikojë praktikën e kodimit, shifrimit ose numrit te dosjeve, për emrat e poseduesve. Gjithashtu, ky kontrollues duhet të kufizohet vetëm në publikimin e poseduesve me praktikën e kodimit, pa bërë publikimin e karakteristikave të objekteve.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

